

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave shpall vende pune për personel akademik me kohë të pjesshme si më poshtë:

A. KRITERET E DEPARTAMENTIT TË SHKENCAVE TË TOKËS PËR PEDAGOGË ME KOHË TË PJESSHME PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025

Në mbështetje të Nenit 39, Pikave 11 dhe 12 të Nenit 42 të Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës, si edhe Vendimit Nr.116, datë 22.09.2020 “Për miratimin e procedurës së punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshëm në UPT”, Departamenti i Shkencave të Tokës ka përcaktuar kriteret sipas lëndëve të mëposhtme:

1. Pedagog i ftuar në lëndën “**Petrografia Magmatike dhe Metamorfike**”, diploma Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike:
 - Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (Diploma e Integruar ose studimet në degën Inxhinieri Gjeologjike (sistemi Bachelor) + Master Shkencor (në Gjeologji Inxhinierike) me notë mesatare mbi 8/10;
 - Të ketë eksperiencë në mësimdhënie dhe punë kërkimore të paktën prej 5 vitesh, në fushën e Gjeologjisë;
 - Të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor” në fushën e Petrologjisë;
 - Do të kenë përparësi kandidatët që kanë patur eksperiencë në mësimdhënie në lëndën e “Petrografisë Magmatike dhe Metamorfike”.
2. Pedagog i ftuar në lëndën “**Mikropaleontologji-Stratigrafi**” (**moduli i mikropaleontologjisë**), diploma MP në Inxhinieri Gjeologjike - profili “Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure”:
 - Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (Diploma e Integruar ose studimet në degën Inxhinieri Gjeologjike (sistemi Bachelor) + Master Shkencor në Gjeologji Inxhinierike me notë mesatare mbi 8/10;
 - Të ketë gradë ose titull shkencor në fushën e Paleontologjisë;
 - T’i përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
 - Të ketë eksperiencë në mësimdhënie.
3. Pedagog i ftuar në modulin “**Petrografia e Shkëmbinjve Sedimentarë**” në lëndën “**Sedimentologji për Inxhinierët e Naftës**”, programi i studimit i nivelit të parë (Bachelor) në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit:
 - Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, dega Gjeologji Naftë (Diplomë e Integruar) ose sistemin Bachelor në Shkenca Toke + Master Shkencor në Gjeologji me notë mesatare mbi 7.5/10.
 - Të ketë eksperiencë pune në institucione lidhur me kërkimin/shfrytëzimin e naftës dhe gazit.
 - Të ketë aktivitet shkencor (botime, referime, projekte etj.) të vazhdueshëm në fushat e e lidhura me naftën dhe gazin.
 - Kandidatët me gradë shkencore ose titull kanë prioritet.
4. Pedagog i ftuar në lëndën “**Etikë komunikimi**”, programi i studimit i nivelit të parë (Bachelor) në Inxhinieri Gjeomjedisi:
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave Sociale/Shkencave Filologjike me notë mesatare mbi 7.5/10;
 - Të ketë specializim apo kualifikim në Fushën e Etikës së Komunikimit/ Shkencave Filologjike;
 - Të ketë eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushën e Shkencave Sociale/ Shkencave Filologjike;
 - Është e preferueshme eksperiencia në mësimdhënie;
 - T’i përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
 - Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).
5. Pedagog i ftuar në lëndën “**Gjeologji Strukturore**”, diploma Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike dhe diploma bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatike:
 - Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (Diploma e Integruar ose studimet në degën Inxhinieri Gjeologjike (sistemi Bachelor) + Master Shkencor (në Gjeologji Inxhinierike) me notë mesatare mbi 8/10.
 - Të ketë realizuar punë kërkimore të paktën prej 5 vitesh, në fushën e Gjeologjisë strukturore.
 - Të ketë gradë shkencore ose titull në fushën e Gjeologjisë Strukturore.
 - Do të kenë përparësi kandidatët që kanë eksperiencë në mësimdhënie në lëndën përkatëse.
 - T’i përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit.
6. Pedagog i ftuar në lëndën: “**Gjeologji e Përgjithshme**”, programi i studimit i nivelit të parë (Bachelor) në Inxhinieri Gjeologjike:
 - Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (Diploma e Integruar ose studimet në degën Inxhinieri Gjeologjike (sistemi Bachelor) + Master Shkencor (në Gjeologji Inxhinierike) me notë mesatare mbi 8/10;
 - T’i përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
 - Të ketë një eksperiencë pune së paku 2- vjeçare si inxhinier gjeolog;
 - Preferohet të ketë kualifikim jashtë shtetit në fushën e gjeologjisë.
7. Pedagog i ftuar për modulin e **Sizmologjisë** në lëndët: “**Sizmikë + Gravimetri**” diploma Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike dhe “**Gjeofizika**” – diploma Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi:
 - Të ketë mbaruar Master Shkencor në Inxhinieri gjeofizike ose Inxhinieri Fizike (ose diplomë të integruar në fushat përkatëse) me notë mesatare mbi 7.5/10;
 - Të ketë një eksperiencë pune së paku 2- vjeçare në fushën e sizmologjisë;
 - Është e preferueshme eksperiencia në mësimdhënie;
 - Të ketë njohuri të sistemeve të shfrytëzimit, programim etj., në fushën përkatëse;
 - Grada apo Titulli Shkencor në fushën e sizmologjisë përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh);
 - Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe t’i përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit.
8. Pedagog i ftuar për zhvillimin e seminareve, në lëndën “**Stratigrafi – Basenet Sedimentare**”, programi i studimit i nivelit të parë (Bachelor) në Inxhinieri Gjeologjike:

- Të ketë mbaruar studimet në deget e Gjeologjisë (Diploma e Integruar ose në sistemin Bachelor + Master Shkencor) me notë mesatare mbi 8/10.
 - T'i përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit.
 - Të ketë një eksperiencë pune ne fushen e gjeologjise regjionale.
 - Kualifikime ose grada shkencore në fushën e Stratigrafisë përbën prioritet.
- 9. Pedagog i ftuar në lëndët “Gjeofizikë Kantierale”** programi i studimit i nivelit të dytë (Master) në Inxhinieri Naftë dhe Gaz, **“Gjeofizika e Puseve”** programi i studimit i nivelit të parë (Bachelor) në Inxhinieri Gjeologjike dhe **“Diagrafi”** programi i studimit i nivelit të dytë (Master) në Gjeologji Vendburime Hidrokarbure.
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në degën Gjeofizikë ose të ketë mbaruar studimet në universitetet jashtë vendit në të njëjtin profil.
 - Të ketë së paku gradën shkencore “Doktor”.
 - Të ketë eksperiencë në aplikimin e metodave gjeofizike në pus.
 - Eksperienca në mësimdhënie në fushën e aplikimit të metodave gjeofizike në matjet në puse përbën avantazh.
- 10. Pedagog i ftuar në cikël leksionesh në lëndën “Mineralogji-Petrografi”**, programi i studimit i nivelit të parë (Bachelor) në degën Inxhinieri Materiale:
- Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, Diplomë të Integruar ose sistemin Bachelor + Master Shkencor me notë mesatare mbi 7.5/10.
 - Të ketë gradë shkencore fushën e gjeoshkencave.
 - Të ketë eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitet shkencor (atikuj, konferenca, projekte etj).
 - Kandidatët me gradë shkencore përbëjnë prioritet.
- 11. Pedagog i ftuar për cikël leksionesh në lëndën “Paleoekologji – Ndryshimet globale”** programi i studimit i nivelit të parë (Bachelor) në Inxhinieri Gjeomjedisit:
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës (diploma Bachelor + Master Shkencor në Biologji ose diploma Bio-Kimi në sistemin e vjetër), me notë mesatare mbi 8/10;
 - Të ketë eksperiencë pune së paku 3 – 5 vjeçare në Fushën e Shkencave Biologjike ;
 - Është e preferueshme eksperienca në mësimdhënie;
 - T'i përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit.
- 12. Pedagog i ftuar në cikël leksionesh në lëndën “Sedimentologji e Aplikuar”**, programi i studimit i nivelit të dytë (MP) Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e Vendburimeve të Hidrokarbureve
- Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, dega Gjeologji Naftë (Diplomë e Integruar) ose sistemin Bachelor në Shkenca Toke + Master Shkencor në Gjeologji me notë mesatare mbi 7.5/10.
 - Të ketë eksperiencë pune në institucione lidhur me kërkimin/shfrytëzimin e naftës dhe gazit.
 - Të ketë aktivitet shkencor (botime, referime, projekte etj.) të vazhdueshëm në fushat e e lidhura me naftën dhe gazin.
 - Kandidatët me gradë shkencore ose titull si dhe eksperiencë në mësimdhënie kanë prioritet.

B. DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË ENERGJISË, KA PËRCAKTUAR KRITERET SIPAS LËNDËVE NË VIJIM:

1. Etikë Komunikimi në diplomën Bachelor në *Inxhinierinë NaftësdheGazit*.

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave Sociale/Shkencave Filologjike me notë mesatare mbi 7.5/10;
- Të ketë specializim apo kualifikim në Fushën e Etikës së Komunikimit/ Shkencave Filologjike;
- Të ketë eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushën e Shkencave Sociale/ Shkencave Filologjike;
- Është e preferueshme eksperienca në mësimdhënie;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
- Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasys).

2. Hyrje në Inxhinierinë e Burimeve Natyrore në diplomën Bachelor në *Inxhinierinë e Naftës dheGazit/Inxhinierinë e Gjeomjedisit/Inxhinierinë Gjeoinformatike/Inxhinierinë e Burimeve Minerare*.

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në Sistemin 5 – vjeçar ose në Sistemin Bachelor + Master në Sistemin me dy Cikle ose diplomuar në Universitete/Fakultete të tjera, gjithmonë në Fushën e Gjeologjisë dhe të Minierave), me notë mesatare mbi 7.5/10;
- Të ketë specializime, kualifikime apo diplomë në Fushën e Gjeologjisë ose të përafërta;
- Të ketë eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushat respektive;
- Është e preferueshme eksperienca në mësimdhënie;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
- Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasys).

3. Ligjshmëri/Ekonomi dhe e Drejtë Komunitare në diplomën Bachelor në *Inxhinierinë e Naftës dheGazit//Master Profesional në Inxhinierinë e Gjeomjedisit*.

- Të ketë mbaruar Fakultetin Juridik me notë mesatare mbi 7.5/10;
- Të ketë specializime, kualifikime apo diplomë në Fushën e Gjeologjisë ose të përafërta;
- Të ketë eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushat respektive;
- Është e preferueshme eksperienca në mësimdhënie;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
- Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasys).

4. Burimet e Energjisë/Inxhinieria e Burimeve të Energjisë në DiplomënMaster Profesional në *Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit/Master Profesional në Inxhinierinë e Gjeomjedisit*.

- Të jetë diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës (në Sistemin 5 – vjeçar ose në Sistemin Bachelor + Master në Sistemin me dy Cikle me notë mesatare mbi 7.5/10);
- Të ketë një eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushën e Inxhinierisë së Burimeve të Energjisë (Burime të Rinovueshme apo të Shtershme/Hidrokarbure);
- Është e preferueshme eksperiencia në mësimdhënie;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
- Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).

5. Inxhinieri Shpimi në Diplomën e Studimeve të Ciklit të Tretë “Doktorata në *Inxhinieri Naftë dhe Gaz*”.

- Të jetë diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës (në Sistemin 5 – vjeçar ose në Sistemin Bachelor + Master në fushën e Inxhinierisë së Naftës dhe Gazit);
- Të ketë Kualifikim që bën ti përkasë Kategorisë “Profesor”;
- Të ketë një eksperiencë pune mbi 15 vjeçare në Fushën e Inxhinierisë së Burimeve të Energjisë (Burime të Rinovueshme apo të Shtershme/Hidrokarbure);
- Të ketë eksperiencë mbi 15 vjeçare në mësimdhënie, me përparësi Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit.

6. Lëngjet e Shpimit në Diplomën e Studimeve të Ciklit të Tretë “Doktorata në *Inxhinieri Naftë dhe Gaz*”.

- Të jetë diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës (në Sistemin 5 – vjeçar ose në Sistemin Bachelor + Master në fushën e Inxhinierisë së Naftës dhe Gazit);
- Të ketë Kualifikim që bën ti përkasë Kategorisë “Profesor”;
- Të ketë një eksperiencë pune mbi 15 vjeçare në Fushën e Inxhinierisë së Burimeve të Energjisë (Burime të Rinovueshme apo të Shtershme/Hidrokarbure);
- Të ketë eksperiencë mbi 15 vjeçare në mësimdhënie, me përparësi Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit.

7. PËR CIKËL LEKSIONESH NË LËNDËT:

7.1. Pajisje Shpimi:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në Sistemin 5 – vjeçar në Degën e Shpimit dhe Shfrytëzimit të Vendburimeve Hidrokarbure ose në Sistemin Bachelor + Master në Sistemin me dy Cikle gjithnjë në Fushën e Inxhinierisë së Naftës (ose diplomuar në Universitete/Fakultete të tjera gjithmonë në Fushën e Inxhinierisë së Naftës), me notë mesatare mbi 7.5/10;
- Të ketë një eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushën e Inxhinierisë së Burimeve Natyrore (Shpim Pusesh, Shfrytëzim Vendburimesh Hidrokarbure);
- Është e preferueshme eksperiencia në mësimdhënie;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
- Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).

7.2. Inxhinieria e Nxjerrjes së Naftës dhe Gazit:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave (Sistemin 5 – vjeçar në Degën e Shpimit-Shfrytëzimit të Vendburimeve Hidrokarbure ose Sistemin Bachelor + Master në Fushën e Inxhinierisë së Naftës (ose diplomuar në Universitete/Fakultete të tjera në Fushën e Inxhinierisë së Naftës)), me notë mesatare mbi 7.5/10;
- Të ketë specializime, kualifikime apo diplomë në Fusha të përafërta;
- Të ketë eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushat respektive;
- Është e preferueshme eksperiencia në mësimdhënie;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
- Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).

7.3. Inxhinieri Rezervuari:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave (Sistemin 5 – vjeçar në Degën e Shpimit dhe Shfrytëzimit të Vendburimeve Hidrokarbure ose Sistemin Bachelor + Master në Sistemin me dy Cikle në Fushën e Inxhinierisë së Naftës), me notë mesatare mbi 7.5/10;
- Të ketë specializime, kualifikime apo diplomë në Fusha të përafërta;
- Të ketë eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushat respektive;
- Është e preferueshme eksperiencia në mësimdhënie;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
- Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).

C. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË SË BURIMEVE MINERARE, KA PËRCAKTUAR KRITERET SIPAS LËNDËVE NË VIJIM:

1. Një personel akademik me kohë të pjesshme në diplomën Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare, për lëndën Etikë Komunikimi.

Kandidati për këtë pozicion duhet:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave Sociale/Shkencave Filologjike me notë mesatare mbi 7.5/10;
- Të ketë specializim apo kualifikim në Fushën e Etikës së Komunikimit/ Shkencave Filologjike;
- Të ketë eksperiencë pune së paku 2 – 3 vjeçare në Fushën e Shkencave Sociale/ Shkencave Filologjike;
- Është e preferueshme eksperiencia në mësimdhënie;
- Ti përgjigjet me prioritet nevojave të mësimdhënies së Departamentit;
- Grada apo Titulli Shkencor përbën prioritet (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).

2. Një personel akademik me kohë të pjesshme pranë Grupit mësimor kërkimor Inxhinieri miniere dhe Pasurim i mineraleve dhe mbetjeve për fushën e inxhinierisë së minierave.

Kandidati për këtë pozicion duhet:

- Të ketë mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, sistemi pesë vjeçar në degën Inxhinier Miniere, Master Shkencor në Gjeoinxhinieri, inxhinieri Miniere ose në fushën e inxhinierisë së minierave në universitete jashtë vendit;
- Të jetë specialist i afirmuar në fushën e minierave në përgjithësi.
- Të ketë notë mesatare mbi 7.5.

- Grada Shkencore përbën përparësi (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).

3. Një personel akademik me kohë të pjesshme pranë Grupit mësimor kërkimor Inxhinieri miniere dhe Pasurim i mineraleve dhe mbetjeve për fushën e shfrytëzimit në minierë.

Kandidati për këtë pozicion duhet:

- Të ketë mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, sistemi pesë vjeçar në degën Inxhinier Miniere, Master Shkencor në Gjeoinxhinieri ose në fushën e inxhinierisë së minierave në universitete jashtë vendit;
- Të jetë specialist i afirmuar në fushën e minierave në përgjithësi dhe në fushën e shfrytëzimit në sipërfaqe të vendburimeve të mineraleve në vecanti.
- Të ketë note mesatare mbi 7.5.
- Grada shkencore përben përparësi (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).

4. Një personel akademik me kohë të pjesshme pranë Grupit mësimor kërkimor Inxhinieri miniere dhe Pasurim i mineraleve dhe mbetjeve për fushën e mekanikës së shkëmbinjve.

Kandidati për këtë pozicion duhet:

- Të ketë mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, sistemi pesë vjeçar në degën Inxhinier Miniere, Master i Shkencave në Gjeoinxhinieri ose në fushën e inxhinierisë së minierave në universitete jashtë vendit;
- Të jetë specialist i afirmuar në fushën e inxhinierisë së minerave në përgjithësi dhe mekanikës së shkëmbinjve në vecanti.
- Të ketë note mesatare mbi 7.5.
- Grada shkencore, përvoja në punë në fushën e inxhinierisë së minierave dhe botimet shkencore në këtë fushë përbëjnë përparësi (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).

5. Një personel akademik me kohë të pjesshme pranë Grupit mësimor kërkimor Inxhinieri minere dhe Pasurim i mineraleve dhe mbetjeve në fushën e Përpunimit të mineraleve dhe të riciklimit të mbetjeve.

Kandidatët për këtë pozicion duhet:

- Të kenë mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, Fakultetin e Shkencave të Natyrës në UT ose Universitete të Huaj, sistemi pesë vjeçar ose Master Shkencor në fushën e Përpunimit të mineraleve dhe mbetjeve.
- Të jetë specialist i afirmuar në fushën e Pasurimit të mineraleve.
- Të kenë notë mesatare mbi 7.5.
- Grada shkencore/ Titulli, përvoja në punë në fushën e pasurimit të mineraleve dhe botimet shkencore në këtë fushë përbëjnë përparësi (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).
- Të ketë përvojë mbi 5 vjet në mësim dhënie.

6. Një personel akademik me kohë të pjesshme pranë Grupit mësimor Gjeomatika të specializuar në fushën e Matjeve në Miniera.

Kandidatët për këtë pozicion duhet:

- Të kenë mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave ose në Universitete të Huaj, sistemi pesë vjeçar ose Master Shkencor në fushën e Gjeomatikës; Gjeoinxhinierisë.
- Të jetë specialist i afirmuar në fushën e Gjeomatikës në përgjithësi dhe në atë të matjeve në miniera në vecanti.
- Të ketë notë mesatare mbi 7.5.
- Grada shkencore/ Titulli, përvoja në punë në fushën e gjeomatikës dhe botimet shkencore në këtë fushë përbëjnë përparësi (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).
- Të ketë përvojë mbi 5 vjet në mësim dhënie.

7. Një personel akademik me kohë të pjesshme pranë Grupit mësimor Gjeomatika të specializuar në fushën e Gjeodezisë satelitore dhe Përpunimit të matjeve topografike.

Kandidatët për këtë pozicion duhet:

- Të kenë mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave ose në Universitete të Huaj, sistemi pesë vjeçar ose Master Shkencor në fushën e Gjeomatikës; Gjeoinxhinierisë.
- Të jetë specialist i afirmuar në fushën e Gjeomatikës në përgjithësi dhe në atë të matjeve në miniera në vecanti.
- Të ketë notë mesatare mbi 7.5.
- Grada shkencore/ Titulli, përvoja në punë në fushën e gjeomatikës dhe botimet shkencore në këtë fushë përbëjnë përparësi (në këtë rast mesatarja nuk merret parasysh).
- Të ketë përvojë mbi 5 vjet në mësim dhënie.

- Shkalla e angazhimit të personel akademik me kohë të pjesshme do të varet nga hapja e profileve të Diplomave Master Profesional dhe Master Shkencor.

D. DEPARTAMENTI I GJEOLOGJISË SE ZBATUAR DHE I GJEONFORMATIKËS SHPALL NEVOJAT DHE KRITERET PËR PEDAGOGË TË FTUAR PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 SI MË POSHTË VIJON:

1. Dy pedagogë të ftuar pranë Grupit mësimor-kërkimor të Vendburimeve

Kandidatët për këtë pozicion duhet:

- Të kenë mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave;
- Të kenë notë mesatare mbi 8;
- Të jenë specialistë i afirmuar në fushën e gjeologjisë së vendburimeve;
- Të kenë njohuri mbi fazat e kërkim-zbulimit dhe planet e zhvillimit të vendburimeve;

- Të kenë drejtuar projekte në fushën e gjeologjisë dhe të përpunimit të vendburimeve;
- Gradat shkencore apo specializimet në vendet e Bashkimit Europian etj.,përbëjnë avantazh.

Fituesit do të aktivizohen sipas nevojave të Departamentit si në mësimdhënie edhe në udhëheqjen e Projekt-Diplomave pasi propozimet e temave të miratohen në Departament.

2. Pedagog i ftuar pranë Grupit mësimor-kërkimor të Gjeoinformatikës.

Për këtë pozicion duhet:

- Të ketë mbaruar studimet e larta, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dega Inxhinieri Informatike, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dega Informatikë,Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Dega Gjeoinformatikeose Fakultete ekuivalente të Huaj, sistemi pesë vjeçar ose Bachelor dhe Master Shkencor në fushën e Informatikës.
- Të ketë notë mesatare mbi 8;
- Te kete njohuri dhe eksperience ne fushen e inxhinierise se programeve.
- Eksperienca në mësimdhënie përbën avantazh.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
2. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
3. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
4. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
7. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paragesin brenda datës 25.09.2024 pranë Departamenteve përkatëse, dokumentacionin e sipërcituar.